

Delës-fiziana

Nr.

Br.

IX-06

Data

Datum

26.01.2022



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO**  
**KOMUNA E OBILIQIT**  
**OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC**



**KOMISIONI KOMUNAL I AKSIONARËVE – NPL “KASTRIOTI” Sh.A**

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 5.2, 16 dhe 17 të Ligjit nr.03/L-087, për Ndërmarrjet Publike (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.31/15 qershor 2008), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.05/L-009 dhe Ligjin nr. 04/L-111, vendimin e Kuvendit të Komunës nr.I-4, datë 24.12.2021, pas mbledhjes së mbajtur me datë 26.01.2022, shpall:

**KONKURS**

**Për zgjedhjen e 4 anëtarëve në Bordin e Drejtorëve  
të NPL “KASTRIOTI” Sh.A Obiliq**

**Drejtorët e Bordit Të Ndërmarrjes Publike Komunale “Kastrioti” Sh.A Numri dhe Mandati i Tyre.**

Ndërmarrja Publike Lokale “Kastrioti” Sh.A., Obiliq – 4 drejtor;  
Mandati i drejtorit të zgjedhur nga ana e Komisionit Komunal të Aksionarëve është tri (3) vjet.

**Kompensimi i Drejtorëve të NPL “Kastrioti” Sh.A. Obiliq.**

Kompensimi i drejtorëve të bordit të NPK do të bëhet në pajtim me dispozitat e nenit 20, paragrafi 20.2 të Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.

**KUALIFIKIMET DHE PËRGATITJA PROFESIONALE**

Sipas nenit 17, pika 17.3 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, një kandidat për t'u zgjedhur drejtor në Bordin e drejtorëve të NPL duhet t'i plotësojë këto kushte:

- të jetë person që ka integritet të njohur, duke marrë parasysh, ndër tjera, çfarëdo shkelje materiale të detyrave fiduciare që mund të ketë bërë ky person ndaj cilitdo person tjetër;
- të ketë përgatitje superiore;
- duhet ose (i) të ketë së paku pesë (5) vite përvojë pune pas diplomimit – së paku në një nivel të lartë të menaxhmentit në fushën e administrimit të biznesit, financave korporative, financa, menaxhim i thesari, banka, konsulencë në biznes ose industri ose nga një fushë tjetër e shkencës ose njohurisë e cila ka të bëjë me veprimtarinë afariste të NP-së; ose (ii) për së paku pesë (5) vite, të ketë qenë kontabilist publik, jurist i kualifikuar, ose anëtar i kualifikuar i një profesioni tjetër i cili ndërlidhet ngushtë me veprimtarinë afariste të NP-së.

**Të dërgohet dëshmia e përvojës së punës duke përfshirë edhe raportin e trustit pensional.**

## KUSHTET

### **Kandidati ka të drejtë të zgjidhet në Bordin e NPL, nëse:**

- Nuk ka qenë i dënuar dhe nuk është nën hetime nga një gjykatë kompetente; (dëshmia jo më e vjetër se 6 muaj);
- Nuk ka shkelur kodin etik, apo standardet e sjellës profesionale, përveç nëse një dënim i tillë është ndryshuar nga një gjykatë ose organ tjetër i ankesave;
- Nuk ka bërë përgënjeshtime materiale nën çfarëdo dëshmie nën betim;
- Nuk ka qenë në post menaxhues të ndonjë kompanie që ka falimentuar gjatë dhjetë (10) vjetëve të fundit.
- Nuk punon në ndonjë institucion ku bëhen politikat zhvillimore për Ndërmarrje Publike përkatëse ku kandidati punon.

### **Kandidati nuk mund të zgjidhet drejtor në Bordin e NPL, nëse:**

- Aktualisht është zyrtar (në kuptim të nenit 21 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike), menaxher i ndërmarrjes përkatëse, ose cilëso nga filialet e saj, ose ka shërbyer si menaxher i ndërmarrjes publike përkatëse, ose cilëso nga filialet e saja brenda pesë (5) vjetëve të kaluara;
- Aktualisht ka, ose gjatë tri (3) viteve të kaluara ka pasur çfarëdo marrëdhënie materiale afariste (përveç si konsumator individual i shërbimit të ndërmarrjes publike) me ndërmarrjen publike përkatëse, ose cilëndo nga filialet, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë, ose të tërthortë;
- Është aksionar, drejtor ose zyrtarë, në një shoqëri tregtare ose person tjetër juridik, i cili ka marrëdhënie materiale afariste me ndërmarrjen publike përkatëse;
- Pranon, ose ka pranuar brenda tri (3) viteve të kaluara kompensimin shtesë nga ndërmarrja publike përkatëse, ose nga cilado filialë e saj (përveç honorarit të drejtorit ose kompensimin stimulues të përcaktuar në nenin 20.1 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, ose është anëtar në skemën pensionale të ndërmarrjes publike përkatëse, ose të cilëso nga filialat e saj;
- Përfaqëson një aksionar, i cili posedon mbi dhjetë përqind (10%) të aksioneve votuese në ndërmarrjen publike përkatëse;
- Ka shërbyer në Bordin e drejtorëve të ndërmarrjes publike përkatëse, më shumë se nëntë (9) vite nga dita e parë e zgjedhjes së tij;
- Është i afërm i shkallës së tretë (siç është konstatuar në përputhje me përkufizimin e interesit financiar në nenin 2 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike), i cilitdo person që i takon cilëso nga kategoritë e sipër përmendura;
- Është zyrtar, drejtor ose aksionar, ose ka një interes financiar në një shoqëri tregtare që konkurren me ndërmarrjen, ose është një menaxher i lartë zyrtar, drejtor ose aksionar ( i cili posedon më shumë se dy përqind (2%) të të drejtave të votimit), ose ka një interes të konsiderueshëm financiar në cilëndo nga shoqëritë tregtare që konkurrojnë në ndërmarrjen;
- Është, ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës 36 mujore para datës së aplikimit, ka qenë zyrtar i zgjedhur, i emëruar politik, ose bartës i një posti udhëheqës ose vendimmarrës, në një parti politike;
- Ka çfarëdo konflikti të interesave që, për nga natyra, do të shkaktonte që ky person të mos jetë në gjendje që në mënyrë efektive, me besnikëri, në mënyrë të pavarur dhe objektive t'i përmbushë detyrat e tij përgjegjëse ndaj aksionarëve dhe ndërmarrjes publike.

## **INFORMATË PËR PROCEDURËN E KONKURIMIT**

Kandidatët për drejtor në Bordin e drejtorëve të NPL “KASTRIOTI” Sh.a, duhet t'i dorëzojnë provat e mëposhtme:

- CV-në,
- Letër motivimi,
- Deklaratën nën betim (formular, i cili plotësohet në momentin e dorëzimit të dokumentacionit),
- Dëshminë mbi përvojën e punës,
- Certifikatën që nuk është nën hetime nga Gjykata kompetente, jo me vjetër se 6 muaj nga data e shpalljes publike të konkursit,
- Certifikatën e shtetësisë së Kosovës.

Aplikuesi, duhet të përgatisë deklaratën nën betim, (në përputhje nenin 17.5 të Ligjit nr.03/L-087, për Ndërmarrjet Publike) në të cilin deklaron se ai/ajo i përmbush kushtet e kualifikimit; pavarësinë dhe përgatitjen profesionale. Çdo përgënjeshttrim material, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca, ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër përmendur, do të rezultojë me diskualifikimin e menjëhershëm.

**Afati i konkursit është i hapur 30 ditë nga data e publikimit në tabelën e shpalljeve dhe në web-faqen e komunës së Obiliqit (nga data 26/01/2022 deri me 25/02/2022).**

Aplikacionet dorëzohen në objektin e komunës së Obiliqit adresa Rr.Adem Jashari nr.2 Obiliq 15000, Republika e Kosovës.

Me rastin e aplikimit kandidatët duhet të bashkëngjisin kopjet e dokumenteve të kërkuara ndërsa origjinalet mund të kërkohen gjatë intervistës.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen.

Konkursi mbetet i hapur 30 ditë kalendarike nga dita e shpalljes.

Informatat shtesë mund të sigurohen përmes web-faqes së komunës.